



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23. 07. 2024

Nr: 113

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË BASHKIMI DEMOKRAT SHQIPTAR PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Sot më datë 23.07.2024, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 2088 Prot., datë 22.07.2024, me:

Kërkues: “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me kryetar z. Ylber Valteri.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” (PBD), si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, ka caktuar datën 4 Gusht 2024, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.

“Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Ylber Valteri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 Gusht 2024.

Data: 23.07.2024 Nr: 113
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

Nga “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 22.07.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me initiale “PBD”, me kryetar z. Ylber Valteri, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” me shkronja nistore “PBD”, me adresë Rruga “Mine Peza”, vila nr. 4, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Ylber Valteri, me adresë Rruga “Vaçe Zela”, Nr. 48, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është zj. Irena Valteri, me adresë Rruga “Vaçe Zela”, Nr. 48, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Ylli Subashi, me adresë Rruga “Ferit Xhajko”, pranë ish-restorant Durrësit, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, respekton afatin kohor të parashikuar në vendimin nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe vendimit nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me kryetar z. Ylber Valteri, me shkronjat nistore “PBD”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024.

Data: 23.07.2024 Nr:113
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orë nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

